



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c) dhe nenit 40, paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), e në mbështetje të neneve 15, lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 28.01.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim miratohet plani punës i Kuvendit të Komunës në Suharekë, për vitin 2022 dhe orari i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe Komitetit për Komunitet për vitin 2022.

Neni 2

Pjesë për bërse e këtij vendimi është plani punës i Kuvendit të Komunës në Suharekë, për vitin 2021 dhe orari i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe Komitetit për Komunitet për vitin 2022.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në Suharekë.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË



Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI

01-Nr. 0166351
Me datë 28.01.2022